
**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"UNICO WINE" SHPK**

Tiranë, 2022

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "UNICO WINE" SHPK

KREU I EMËRTIMI, FORMA, SELIA, OBJEKTI DHE KOHËZGJATJA

NENI 1 EMËRTIMI DHE FORMA E SHOQËRISË

- 1.1. Shoqëria emërtohet si "UNICO WINE" Sh.p.k. (në vijim "Shoqëria").
- 1.2. Shoqëria UNICO WINE Sh.p.k. themelohet në përputhje me legjislacionin shqiptar në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar dhe rregullohet prej këtij Statuti dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 1.3. Shoqëria ka vulën dhe logon e saj zyrtare.

NENI 2 SELIA

- 2.1. Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: **Tirane, Njesia bashkiake nr.2, Rruga Papa Gjon Pali II, Ndertesa Nr.12, Kati -2, Kodi Postar 1010**
- 2.2. Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër. Organi administrues i Shoqërisë mund të themelojë ose mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi, brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë.

NENI 3 OBJEKTI I SHOQËRISË

- 3.1. Shoqëria ka për Objekt të saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke u fokusuar kryesisht në:
 - a. Tregti me pakicë e artikujve të ndryshëm, ushqimore, jo-ushqimorë, pijeve (vere, vaj, birre e pije të tjera)
 - b. Import – eksport dhe/ose kultivimin, prodhimin, përpunimin e produkteve ushqimore dhe jo-ushqimore,
 - c. Import-eksport i mallrave industriale, ushqimore, pijeve etj;
 - d. Kantine vere; etiketim, Botim, vjetërim, ambalazhim etj e. Aktivitet në fushën e hoteleri turizmit, bar, restorant;
 - e. stokimi dhe ruajtja e produkteve ushqimore - të përpunuara ose të paperpunuara - dhe jo-ushqimore;
 - f. Transport mallrash;
- 3.2. Gjithashtu shoqëria mund të kryejë cdo lloj veprimtarie apo transaksioni tjetër që lidhet me pasuri të luajtshme e të paluajtshme, me kryerjen e veprimeve tregtare, industriale, bankare dhe/ose financiare të çfarëdo lloji dhe natyre, të nevojshme ose të dobishme për arritjen dhe ose plotësimin e objektivit të Shoqërisë, që nuk ndryshon aktivitetin parësor të Shoqërisë dhe nuk bie në kundërshtim me legjislacionin shqiptar në fuqi.

plotësimin e objektivit të Shoqërisë, që nuk ndryshon aktivitetin parësor të Shoqërisë dhe nuk bie në kundërshtim me legjislacionin shqiptar në fuqi.

- 3.3. Shoqëria mund të veprojë në Shqipëri dhe jashtë saj dhe të kryejë çdo aktivitet tjetër të lidhur, ndihmës me qëllim të përmbushje ose të jetë i dobishëm për përmbushjen e objektit të saj.

NENI 4 KOHËZGJATJA

- 4.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore me afat të pacaktuar.

KREU II KAPITALI, KALIMI I KUOTAVE, ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

NENI 5 KAPITALI I SHOQËRISË dhe kuotat

- 5.1 Kapitali i Shoqërisë është 100,000.00 (njëqindmijë) Lekë, i ndarë në 1 (një) kuotë.
- 5.2. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet me vendim të asamblesë së përgjithshme. Në rast zmadhimi apo zvogëlimi të kapitalit themeltar të Shoqërisë, ortakët do të kenë të drejtën e nënshkrimit të zmadhimit apo zvogëlimit të kapitalit në përpjesëtim të drejtë me pjesëmarrjen që zotëron secili në kapitalin e Shoqërisë.
- 5.3. Kapitali i shoqërisë zotërohet nga Joana Robo, ortakë e vetme e shoqërisë si vijon:
- Joana Robo**, shtetas shqiptar, e lindur në Gjirokastrë, më 17.03.1990, identifikuar me kartën e identitetit me nr. 0373245553 dhe numër personal J05317094B i cili zotëron 100 % (njëqind për qind) të kapitalit, të përbërë nga 1 kuotë me vlerë 100,000.00 (njëqindmijë) lekë.
- 5.3 Në rast zmadhimi apo zvogëlimi të kapitalit themeltar të Shoqërisë, ortakët do të kenë të drejtën e nënshkrimit të zmadhimit apo zvogëlimit të kapitalit në përpjesëtim të drejtë me pjesëmarrjen që zotëron secili në kapitalin e Shoqërisë.

NENI 6 KALIMI I KUOTAVE ME TRASHËGIMI OSE SI PASOJË E FALIMENTIMIT

- 6.1. Kuotat e kapitalit janë të kalueshme ndërmjet ortakëve dhe të kalueshme në rrugë trashëgimie.
- 6.2. Kuotat e kapitalit të shoqërisë mund t'u kalohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri pasi t'i ofrohet e drejta e parablerjes ortakëve të tjerë të shoqërisë sic është përcaktuar në pikën 6.3 të këtij neni.
- 6.3. Në rast se kur njëri apo disa nga ortakët dëshirojnë të kalojnë pjesërisht apo plotësisht kuotat që ata zotërojnë në kapitalin e shoqërisë tek të tretët, më parë duhet që oferta për shitje t'u bëhet ortakëve të tjerë të shoqërisë. Kur ortakët që gëzojnë të drejtën e parablerjes kanë dyshimë rreth kuotave të ortakut që kërkon t'i kalojë ato, mund t'i drejtohet gjykatës që të caktojë një ekspert vlerësues. Ortaku që kërkon kalimin e kuotave tek të tretët duhet të lajmërohet sa më shpejt; nëse brenda 4 javëve ortakut nuk i jepet një përgjigje atëherë prezumohet se ortakët e tjerë kanë rënë dakord që kuotat e tij mund t'i kalohen të tretëve.
- 6.4. Kalimi i kuotave do të bëhet me kontratë.
- 6.5. Kuotat mund të pjesëtohen për shkak të kalimit të tyre.



NENI 7 ZMADHIMI I KAPITALIT

- 7.1. Asambleja e Përgjithshme mund të zmadhojë kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar në nenin 9.12 të këtij Akti Themelimi dhe Statuti. Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme për zmadhimin e kapitalit do t'i komunikohet me shkrim ortakëve që janë thirrur por nuk ishin të pranishëm në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme që vendosi për zmadhimin e kapitalit.
- 7.2. Në rast zmadhimi të kapitalit, të gjithë ortakët do të kenë të drejtën të nënshkruajnë zmadhimin e kapitalit, në para Ose me kontribute në natyrë, në përpjesëtim të drejtë me kuotat që zotërojnë në Shoqëri.
- 7.3. Në rast se disa ortakë heqin dorë nga e drejta e nënshkrimit të pjesës së tyre, kapitali i panënshkruar mund të nënshkruhet nga ortakët e tjerë. Në këtë rast, këta ortakë mund të ushtrojnë sërish të drejtën për nënshkrimin e kapitalit, në përpjesëtim të drejtë me kuotat e pjesëmarrjes në Shoqëri.

NENI 8 ZVOGELIMI I KAPITALIT

- 8.1. Asambleja e Përgjithshme mund të zvogëlojë kapitalin e Shoqërisë, me kuorumin e përcaktuar në nenin 9.12 të këtij Akti Themelimi dhe Statuti. Në çdo rast, kapitali i Shoqërisë nuk mund të zvogëlohet nën kufirin e përcaktuar me ligj.
- 8.2. Ortakët e përballojnë zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, në përpjesëtim të drejtë me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e Shoqërisë.

KREU III

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

NENI 9

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

- 9.1. Asambleja e Përgjithshme është organi vendimmarrës i Shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme vendos mbi të gjitha çështjet për të Cilat është kompetente sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë, sipas këtij Akti Themelimi dhe Statuti dhe/ose çdo marrëveshje midis ortakëve të Shoqërisë.
- 9.2. Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, të shprehë vullnetin e tij si dhe të votojë në përputhje me pjesët e kapitalit që ai zotëron në Shoqëri.
- 9.3. Çdo ortak mund të përfaqësohet nga një ortak tjetër Ose nga një përfaqësues i deleguar me prokurë me shkrim.
- 9.4. Ortaku nuk mund të delegojë të drejtën e votës për një pjesë të kuotave të tij të kapitalit, nëse ai voton personalisht për pjesën e mbetur.
- 9.5. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme mund të mbahet brenda Ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ortakët Ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën (conference call) audio Ose video, në përputhje me legjislacionin për shoqëritë tregtare dhe komunikimet elektronike. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme do të qinet e

- mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari i saj dhe Sekretari i mbledhjes, me qëllim që të hartohet dhe të nënshkruhet procesverbali përkatës.
- 9.6. Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga Administratori/ët Ose nga ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit të Shoqërisë. Thirrja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme duhet të bëhet nëpërmjet njoftimit me shkrim Ose me mjete elektronike, dërguar secilit prej ortakëve në adresat e saj. Njoftimi duhet të përmbajë rendin e ditës, vendin, datën dhe orën e mbledhjes.
 - 9.7. Asambleja e Përgjithshme do të mbledhet rregullisht, pavarësisht nga këto formalitete, në rast se të gjithë ortakët apo përfaqësuesit e tyre janë të pranishëm dhe bien dakord për rendin e ditës.
 - 9.8. Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme kryesohen nga Administratori/ët. Asambleja e Përgjithshme cakton një sekretar për çdo mbledhje midis personave të pranishëm.
 - 9.9. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të jenë me shkrim dhe të firmosen nga kryetari dhe sekretari. Me kërkesë të ortakëve, vendimet duhet të përfshijnë dhe deklaratat apo vërejtjet e tyre.
 - 9.10. Asambleja e Përgjithshme mbledhet të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.
 - 9.11. Asambleja e Përgjithshme, në rastin e vendimeve që kërkojnë shumicën e zakonshme, merr vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote ose përfaqësuesit e tyre, që zotërojnë më shumë se 30% (tridhjetë për qind) të kapitalit të Shoqërisë, përveç rasteve të parashikuara më poshtë në nenin 9.12. Në rast se ky kuorum nuk arrihet, Asambleja e Përgjithshme thirret në një mbledhje të dytë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga mbledhja e parë.
 - 9.12. Asambleja e Përgjithshme vendos me votat pro të 3/4 të ortakëve pjesëmarrës apo të përfaqësuar që zotërojnë më shumë se 50% të kapitalit të Shoqërisë për ndryshimin e këtij Akt Themelimi dhe Statuti, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë.

NENI 10

KOMPETENCAT E ASAMBLESE DHE KUORUMI

10.1 Asambleja e Përgjithshme vendos mbi çështjet e mëposhtme:

- a) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar;
- b) ndryshimi i statutit të Shoqërisë;
- c) transformimin, ndarjen, bashkimin, likuidimin ose prishjen e Shoqërisë, si dhe riorganizimin e saj në çdo formë tjetër;
- d) pjestimin e kuotave të Shoqërisë dhe anulimin e tyre;
- e) përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë dhe planin strategjik të zhvillimit dhe mbikëqyr zbatimin e tyre nga Administratori, përfshirë raportimet financiare;
- f) miratimin e buxhetit vjetor dhe planit të biznesit të Shoqërisë dhe çdo ndryshim të tyre;
- g) miratimin e pasyrave financiare në mbyllje të çdo Viti ushtrimor dhe raportet e ecursisë së veprimtarisë të përgatitura nga Administratori;
- h) miratimin e shpërndarjes së fitimeve vjetore;
- i) emërimin dhe shkarkimin e Administratorit dhe Drejtuesit/Menaxhët e lartë të Shoqërisë, si dhe përcaktimin e shpërblimeve përkatëse;
- j) emërimin dhe shkarkimin e ekspertëve kontabël dhe/ose likuiduesve dhe përcaktimin e shpërblimeve përkatëse;
- k) miratimin e degëve dhe zyrave të përfaqësimit të Shoqërisë brenda dhe jashtë vendit;
- l) miratimin e themelimit të shoqërive të reja të Shoqërisë brenda dhe jashtë vendit;
- m) miratimin e krijimit të Joint Ventures dhe bashkëpunimeve të cilat do lloji qofshin që kanë të bëjnë me investim, financim, fitim të drejtash apo pjesëmarrjesh në projekte ekzistuese apo të reja,

- n) blerjen dhe shitjen e pjesëmarrjeve në shoqëri të tjera, si dhe dhënien e kontributit në kapitalin e shoqërive të tjera;
- o) miratimin e kërkesave të reja dhe rinovimin e kërkesave ekzistuese për financimin Shoqërisë apo subjekteve/palëve të treta;
- p) vendosjen e barrëve, hipotekës, pengut apo garanci të çdo lloji tjetër mbi pasuritë e Shoqërisë;
- q) dhënien e çdo garancie korporative ose nënshkrimin e çdo marrëveshje të tjetër për të Siguruar përmbushjen e detyrimeve financiare ose jo financiare ndaj të tretëve;
- r) shitjen e ndërmarrjes ose degeve të ndërmarrjes;
- s) shitjen, blerjen apo shkëmbimin e pasurive të paluajtshme dhe nënshkrimin e kontratave të sipërmarrjes në lidhje me to, duke përjashtuar këtu shitjet e njësisive/objekteve të banimit dhe/ose shërbimit tek klientët e interesuar sipas një plan biznesi të miratuar përkatësisht për çdo projekt imobiliar;
- t) akordimin e huave ose paradhënieve për Administratorët ose Drejtuesit/Menaxherve e lartë apo për nevoja personale;
- u) investimet (CAPEX) e paparashikuara apo në devijim të buxhetit vjetor të Shoqërisë, mbi një vlerë 10.000.000 ALL (dhjetë milion lekë);
- v) shpenzimet (OPEX) e paparashikuara apo në devijim të buxhetit vjetor të Shoqërisë, mbi një vlerë 5.000.000 ALL (pesë milion lekë);
- w) miratimin e rregullores/ve së brendshme të Shoqërisë;
- x) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo Statuti.
- y) Shpërblimin për administratorin/ët

10.2. Ortakët mund të marrin vendime në mënyrë të vlefshme në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 9901, datë 14 mars 2008 tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

KREU IV ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

NENI 11 ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

- 10.1 Shoqëria administrohet nga një apo më shumë Administratorë të cilët zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh. Administratori mund të rizgjidhet dhe shkarkohet në çdo kohë nga Asambleja e Përgjithshme.
- 10.2 Administratori zotëron kompetenca të plota në lidhje me administrimin e Shoqërisë dhe mund të kryejë të gjitha aktet që konsideron të nevojshme për realizimin e objektit të Shoqërisë, përveç atyre që ligji apo ky Akt Themelimi dhe Statut ia rezervon Asamblesë së Përgjithshme apo organeve të tjera të Shoqërisë.
- 10.3 Administratori vepron në përputhje me politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera në administrimin e Shoqërisë. Administratori mund të delegojë persona të tretë për kryerjen e veprimeve dhe akteve që kanë të bëjnë me administrimin e Shoqërisë, duke mbajtur përgjegjësi për të gjitha veprimet e kryera nga të tretët e deleguar për administrimin e Shoqërisë.
- 10.4 Administratori do të veprojë në çdo kohë vetëm në interesin më të mirë të Shoqërisë. Në rast konflikti interesi, Administratori do të njoftojë menjëherë ortakët si dhe do të heqë dorë nga çdo veprim që lidhet me objektin e konfliktit të interesit deri në marrjen e udhëzimeve nga Asambleja e Përgjithshme.
- 10.5. Administratori/ët përfaqëson/jnë ligjërisht Shoqërinë. Administratori ushtron të gjitha fuqite e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të Shoqërisë, në përputhje me nenin 95 të Ligjit nr. 9901, date 14 mars 2008 'Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, i ndryshuar, dhe

a) të kryejë blerjet, shitjet, nënshkrimin e kontratave me palë të treta për mallra, punë, shërbime apo çdo lloj marrëdhënie tjetër e cila nuk është nën përgjegjësinë direkte të Asamblesë së Përgjithshme deri në vlerën e barabartë me 10,000,000.00 ALL (dhjetë milion lekë), për çdo trasaksion apo në agregat. Mbi këtë vlerë për çdo investim, shpenzim apo angazhim të një natyre tjetër të kryer brenda buxhetit të miratuar do të merret miratimi i Asambesë së Përgjithshme me vendim.

b) të miratojë kryerjen e investimeve (CAPEX) dhe shpenzimeve (OPEX) të paparashikuara apo në devijim të buxhetit vjetor të Shoqërisë deri në një vlerë të barabartë me 10,000,000.0 ALL (dhjetë milion lekë), për çdo trasaksion apo në agregat

10.6 Administratori/ët mund të emerojë/në përfaqesues me prokurë speciale ("ad negotia) për kryerjen e nje akti ose kategori aktesh në kufijtë e tagrave që u jane dhënë atyre nga ligji në fuqi ose ky Statut.

10.7 Administratori i parë i Shoqërisë, i caktuar për një afat 5-vjecar, do të jetë:
Joana Robo, shtetas shqiptar, i lindur në Gjirokastrë, më 17.03.1990, identifikuar me kartën e identitetit me nr. 0373245553 dhe numër personal J05317094B.

NENI 12 PËRFUNDIMI I DETYRËS SË ADMINISTRATORIT

12.1 Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

- a. i përfundon mandati;
- b. shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme;
- c. jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar Shoqërinë;
- d. personi nuk gëzon cilësinë e Administratorit sipas parashikimeve të ligjit;
- e. mungon pa arsye në detyrë për më shumë se 6 (gjashtë) muaj radhazi dhe Asambleja e Përgjithshme vendos ta shkarkojë nga detyra.

KREU V KONTROLI FINANCIAR I SHOQËRISË, VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, DIVIDENDI


NENI 13 KONTROLI FINANCIAR

13.1 Kontrolli financiar i Shoqërisë kryhet në përputhje dhe sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Asambleja e Përgjithshme do të emëroje një apo më shumë Ekspertë Kontabël të Autorizuar në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.

NENI 14 VITI FINANCIAR

14.1 Viti Financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.

NENI 15 BILANCI VJETOR



15.1 Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, inventari, raportet e Administratorit dhe të Ekspertit Kontabël të Autorizuar (nëse janë emëruar) miratohen nga Asambleja e Përgjithshme. Administratori i paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme raportin mbi administrimin e Shoqërisë si edhe llogaritë vjetore.

15.2 Dokumentet që kanë të bëjnë me vitin financiar miratohen nga Asambleja e Përgjithshme brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

NENI 16 DIVIDENDI

16.1 Pasi të jenë përmbushur kërkesat e përcaktuara nga Ligji për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, Shoqëria, me shumicë të kualifikuar të votave së Asamblesë të Përgjithshme, mund të vendosë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.

16.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që i bashkëngjiten kuotave, të gjithë dividendët duhet të deklarohen dhe paguhen sipas shumave të paguara në kuotat në të cilat paguhet dividendi. Të gjitha dividendët do të shpërndahen dhe paguhen në mënyrë proporcionale me shumatat e paguara mbi kuotat gjatë çdo pjese ose pjesëve të periudhës në të cilën paguhet dividendi.

KREU VI PRISHJA DHE LIKUIDIMI, LIGJI I ZBATUESHËM, ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

NENI 17 PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË

17.1 Në rastin e prishjes dhe likuidimit të Shoqërisë do të zbatohen dispozitat e parashikuara në ligjin për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.

NENI 18 LIGJI I ZBATUESHËM

18.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Akt Themelimi e Statut dhe ligjin shqiptar. Për sa nul' është parashikuar në këtë akt, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare.

NENI 19 ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

19.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Shoqërisë dhe ortakëve, apo ndërmjet ortakëve dhe trashëgimtarëve të ortakëve ose ortakëve të tjerë dhe/ose Shoqërisë, që kanë për objekt të drejta të lidhura me Shoqërinë, do të zgjidhen miqësisht ndërmjet palëve të interesuara. Në rast se palët nuk arrijnë një zgjidhje miqësore, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë do të jetë kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

NENI 20 DISPOZITAT LIGJORE NE FUQI

20.1. Për gjithcka që nuk parashikohet në këtë Statut, zbatohen dispozitat ligjore ne fuqi
20.2. Ky Akt Themelimi dhe Statut hartohet dhe nënshkruhet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.



20.3. Ngarkohet Av.Olta Çibuku avokate pranë Dhomës së Avokatisë Tiranë me nr. 6099 liçense dhe nr. Personal I95726071F të kryeje veprimet për regjistrimin e akteve pranë QKB-së nëpërmjet nënshkrimit elektronik.

Tiranë, më datë 14 Qershor 2022

ORTAK i Vetëm

JOANA ROBO

